



Data: 29/07/2019

Ref.: 1369/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

#### V E N D I M

- I. Riakreditohet Kolegji “AAB” në nivel institucional për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022 në kampusin kryesorë në Prishtinë dhe degët në Ferizaj dhe Gjakovë.
- II. Riakreditohet programi i studimit i Kolegjit “AAB” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
  - Stomatologji, Dr. Dent., 360 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik
- III. Akreditohen programet e studimit të Kolegjit AAB për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
  - Siguri Kibernetike, BA Profesional, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik
  - Menaxhment Shëndetësor, MSc, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik
  - Produksion, MA, 120 ECTS, maksimumi 75 studentë për vit akademik
  - Koreografi, BA, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik
  - E Drejta Kushtetuese Administrative, LLM, 60 ECTS, 30 studentë për vit akademik
- IV. Obligohet Kolegji AAB që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

I. Kolegji AAB ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi. AKA ka organizuar dy vizita të ndara me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin AAB, me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional dhe të programeve të studimit. Vizita e parë është realizuar me 13.05.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Balint Bachman dhe Peeter Normak, ndërsa vizita e dytë është realizuar me datë 30.05.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Alan Brichwood, Peter Parycek, Zdravko Lackovic, Ulrike Beier dhe Oana Sarbu.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit AAB dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të dy vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Kolegji AAB përmbush substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se Kolegji AAB i plotëson plotësisht tre (3) (Misioni publik dhe objektivat institucionale; Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit, Burimet dhe Hapësirat) ndërsa plotëson substancialisht 8 (tetë) të tjera (Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi; Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Menaxhimi i Cilësisë; Mësimdhënia dhe Mësim marrja; Hulumtimi; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Bashkëpunimi institucional).

Sa i përket programeve të studimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se programet e studimit të cekura më sipër përmbushin substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar dhënien e akreditimit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji AAB
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë